

MARRËVESHJE

në mes të Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Bashkëpunim në Parandalimin dhe Luftimin e Krimit

Republika e Kosovës dhe Hungaria (tutje të referuara si Palët Kontraktuese)

Marrë parasysh marrëdhëniet miqësore në mes të dy vendeve,

Të bindur se bashkëpunimi ndërkombëtar ka rëndësi të madhe në luftën kundër krimit, veçanërisht krimit të organizuar dhe krimeve serioze, terrorizmit, krimet e lidhura me drogën, dhe trafikimin, migrimin e jashtëligjshëm dhe kontrabandës së paligjshme të personave.

Me qëllim të përforcimit dhe thellimit të bashkëpunimit në mes të agjencive bashkëpunuese në interes të sigurisë së tyre të përbashkël,

Me qëllim të luftimit të krimit të organizuar ndërkombëtar edhe në mënyrë më efektive përmes veprimeve të tyre të koordinuara,

Marrë parasysh detyrimet e tyre të dalura nga ndërmarrjet e tyre ndërkombëtare dhe ligjet e tyre të brendshme,

Duke marr pjesë në rezultatet e bashkëpunimit të tyre deri më sot

Janë pajtuar si në vijim:

KAPITULLI I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Përkufizimet

Për qëllimin e kësaj Marrëveshje:

- Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshje (tutje të referuara agjencitë bashkëpunuese) janë:* autoritetet e autorizuar për kryerjen e detyrave të lidhura me parandalimin e krimit, luftimin e krimit dhe zbulimin e krimit në përputhje me ligjet e brendshme të Palëve Kontraktuese;
- Agjencitë qendrore kontaktuese:*
 - për Palën Kontraktuese Kosovare:* Njësia për bashkëpunim ndërkombëtarë në fushën e zbatimit të ligjit, Policia e Kosovës
 - për Palën Kontraktuese Hungareze:* Qendra Ndërkombëtare e Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit e Shtabit të Policisë Kombëtare.
- Autoritetet gjyqësore:*
 - për Palën Kontraktuese Kosovare:* gjykatat e drejtësisë dhe zyret e prokurorisë;
 - për Palën Kontraktuese Hungareze:* gjykatat e drejtësisë dhe zyret e prokurorisë;

4. *Të dhënat personale*: çdo informacion lidhur me një person të identifikuar apo të identifikueshëm.

5. *Të dhëna të ndjeshme*: të dhëna personale që zbulojnë origjinën racore, përkatësinë me minoritete kombëtare apo etnike, opinione politike apo përkatësi partiake, besime religjioze apo të tjera, anëtarësimin në organizata përfaqësuese, si dhe të dhëna personale sa i përket shëndetit, varësisë patologjike apo jetës seksuale dhe të dhëna personale kriminale.

Neni 2

Fushëveprimi i bashkëpunimit

(1) Me qëllim të mbrojtjes së rendit publik dhe sigurisë publike, Palët Kontraktuese do të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e parandalimit, zbulimit dhe përndjekjen e veprave penale (tutje: luftimin e krimit) të sanksionuar në bazë të ligjeve kombëtare të të dyja Palëve Kontraktuese me burgim prej së paku një viti.

(2) Secila Palë Kontraktuese mund pjesërisht apo tërësisht të refuzojë bashkëpunimin apo mund të kushtëzojë atë me kushte nëse bashkëpunimi i tillë rrezikon apo shkel sovranitetin e tij, sigurinë, rendin publik apo nëse është në kundërshtim me ligjet e tij.

(3) Kërkesa për bashkëpunim sa i përket krimeve ushtarake apo krimeve të kryera për arsye politike nuk do të dorëzohen dhe nuk do të ekzekutohen. Një akt nuk do të konsiderohet krim politik nëse në rrjedhën e kryerjes së tij – me konsideratë ndaj të gjitha rrethanave duke përfshirë qëllimin e kërkuar që të arrihet, motivin, modus operandi dhe mjetet e përdora apo me qëllim të përdoren – aspektet ligjore të aktit tejkalon natyrën e tij politike.

(4) Bashkëpunimi i bazuar në këtë Marrëveshje nuk do të zgjerohet në drejtim të asistencës së ndërsjellë e cila është nën kompetencë të autoriteteve gjyqësore të Palëve Kontraktuese.

KAPITULLI II

Rregullat e përgjithshme të Bashkëpunimit

Neni 3

Bashkëpunimi në bazë të kërkesës

(1) Me qëllim të zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshje, agjencitë bashkëpunuese – në përputhje me ligjet e brendshme të Palëve Kontraktuese dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje – do të bashkëpunojnë dhe do të ofrojnë asistencë ndaj njëri tjetrit në bazë të kërkesës.

(2) Vetëm nëse parashihet ndryshe në këtë Marrëveshje, kërkesat dhe përgjigjet e tyre do të dërgohen dhe pranohen me shkrim (duke përfshirë dërgimin nga telefaksi dhe rrjetit të telekomunikimeve elektronike) përmes agjencive qendrore të kontaktit. Në raste urgjente, kërkesat mund të bëhen verbalisht; kërkesat verbale do të konfirmohen në të shkruar pa asnjë vonesë.

(3) Nëse, në përputhje me ligjet brendshme të Palëve Kontraktuese, pëlqimi, aprovimi apo pajtimi i autoriteteve gjyqësore kërkohet për dërgimin apo ekzekutimin e kërkesës, kërkesat mund

të dërgohen dhe ekzekutimi i tyre mund të fillojë vetëm pasi është marrë leja e tillë, pëlqimi, aprovimi dhe pajtimi i tillë.

(4) Nëse agjencia e kërkuar bashkëpunuese nuk ka fuqi apo kompetencë për të ekzekutuar kërkesën, do të përcjellë kërkesën tek agjencia e cila ka fuqinë dhe kompetencën dhe për këtë njofton agjencinë kërkuese bashkëpunuese.

(5) Agjencia kërkuese bashkëpunuese mund të kërkojë agjencinë e kërkuar bashkëpunuese të ekzekutojë kërkesën e tij në përputhje me rregullat dhe kushtet apo duke aplikuar metodat teknike të caktuara nga ata. Nëse, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kërkesë, ekzekutimi i saj është i mundur vetëm pjesërisht apo nuk është i mundur fare, agjencia e kërkuar qendrore e kontaktit, do të njoftojë agjencinë kërkuese qendrore të kontaktit pa asnjë vonesë. Në të njëjtën kohë, duhet të tregojë kushtet në bazë të të cilave kërkesa mund të ekzekutohet.

(6) Nëse pas marrjes së kërkesës bëhet e dukshme se ekzekutimi i saj është i pamundur brenda afateve kohore të përcaktuara nga ato dhe arsyeja e dhënë në kërkesë për vendosjen e afatit kohor zbulon se një vonesë mund të rrezikojë suksesin e procedurës së agjencisë kërkuese bashkëpunuese, autoriteti i kërkuar bashkëpunues apo agjencia qendrore e kontaktit do të njoftojë agjencinë kërkuese qendrore të kontaktit për kohën e nevojshme për ekzekutimin e kërkesës.

(7) Pas njoftimit, në përputhje me paragrafët (5) dhe (6), agjencia kërkuese qendrore e kontaktit do të deklarojë nëse ende kërkohet ekzekutimi i kërkesës bazuar në rrethanat e zbuluara.

(8) Në rrjedhën e ekzekutimit të kërkesës, agjencia e kërkuese bashkëpunuese dhe agjencitë e tjera pjesëmarrëse në ekzekutimin e kërkesës do të veprojnë në përputhje me rregullat e përcaktuara në Paragrafin (5) të këtij Neni me kusht se ato nuk janë në kundërshtim me ligjet e brendshme të shtetit të agjencisë kë kërkuar bashkëpunuese.

Neni 4

Përmbajtja e Kërkesës dhe Gjuha e Aplikueshme

(1) Kërkesa së paku do të ketë përmbajtjen si në vijim:

- a) Emri i agjencisë kërkuese bashkëpunuese;
- b) Bazën ligjore, qëllimin dhe lënda e kërkesës;
- c) Përshkrimi dhe kualifikimet ligjore të veprimit i cili përbën lëndën e kërkesës;
- d) Afatin kohor të përcaktuar për ekzekutimin e kërkesës, arsyen për kërkimin e ekzekutimit urgjent.

(2) Dokumentet dhe të dhënat e lidhura me përmbajtjen e kërkesës do të bashkëngjiten në kërkesë.

(3) Në rrjedhën e zbatimit të kësaj Marrëveshje, agjencitë bashkëpunuese do të përdorin gjuhën angleze, mirëpo mund të pajtohen të përdorin gjuhë të tjera për komunikimin e tyre.

KAPITULLI III Format e bashkëpunimit

Neni 5 Shkëmbim i informacionit

(1) Agjencitë bashkëpunuese, sipas kërkesës, do të transferojnë, në veçanti, informacionet e mëposhtme:

- a) të dhënat personale identifikuese të personave të përfshirë në kryerjen e një veprë penale, kontaktet e tyre në lidhje me këtë veprë penale: mbiemri, mbiemri i mëparshëm, emëri, emra të tjerë (alias, emri, pseudonimi, imitimin), gjinia, data dhe vendi i lindjes, vendbanimin aktual dhe çdo kombësi e mëparshme;
- b) planifikimin, tentimin ose kryerjen e veprave penale, në veçanti të dhënat që lidhen me kohën, vendin, modus operandin, informacionin mbi rrethanat e veçanta dhe masat e ndërmarra, kudo që është e nevojshme për luftimin e krimit;
- c) Informacione për objektet, në kuptim se për të cilat janë kryer shkeljet penale, apo të cilat përmbajnë gjurmë të veprave kriminale, apo janë përdorur ose kanë pasur për qëllim të përdoren si një instrument (mjet) i krimit, apo kanë prejardhje nga një shkelje penale;
- d) Të dhënat për procedimet e krimit;
- e) Të dhëna nga baza e të dhënave kriminale e qasshme për autoritetet bashkëpunuese;
- f) Informacione për identitetin e personave, vendin e tyre të qëndrimit dhe adresën e shtëpisë;
- g) Informacione për dokumentet që përbëjnë të drejtën për të drejtuar mjete të ndryshme të transportit;
- h) Të dhëna identifikuese të mjeteve motorike;
- i) Të dhëna të cilat i takojnë pronarit, operatorit dhe / apo përdoruesit të mjeteve të transportit;
- j) Të dhëna të cilat i takojnë licencave të armëve të zjarrit;
- k) Të dhëna të cilat identifikojnë pronarin, dhuruesin dhe përdoruesin e pajisjeve të terminalit të telekomunikimit elektronik ;
- l) Të dhënat të cilat i përkasin dokumenteve të cilat përbëjnë të drejtën për të kaluar kufijtë shtetëror apo për të qëndruar në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese;
- m) Të dhënat të cilat i takojnë personit me ekspertizë të veçantë.

(2) Agjencitë bashkëpunuese mund të shkëmbejnë:

- a) Informacione për metodat dhe format e reja të aktiviteteve kriminale ndërkombëtare;

- b) Rezultate të hulumtimeve kriminale, kriminologjike dhe krime të tjera, informacione për praktikën, metodat e punës dhe instrumentet e përdorura në luftimin e krimit;
 - c) Informacione për rregullimin e brendshëm ligjor të akteve kriminale.
- (3) Kërkesat për të transferuar të dhëna siq është përcaktuar në paragrafin (1) pika a)-1) të këtij neni mund të transmetohet dhe ekzekutohen drejtpërdrejt në mes të agjencive bashkëpunuese në rast shkëmbimit informacioneve përmes pikave qendrore të kontaktit do të shkaktonte vonesë dhe do të kishte pasoja serioze si dhe do të rrezikonte interesin e zbulimit të krimit.
- (4) Në raste të veçanta, agjencitë qendrore të kontaktit të Palëve Kontraktuese mund të transferojnë informacione edhe pa kërkesë, nëse mund të supozohet racionalisht se ky informacion është i nevojshme për agjencitë bashkëpunuese të Palëve Kontraktuese për të eliminuar kërcënime konkrete ndaj rendit publik apo për të luftuar krimet.
- (5) Në rrjedhën e shkëmbimit të informacionit sipas këtij Neni, agjencitë bashkëpunuese mund të shkëmbejnë kërkesa që përmbajnë të dhëna të klasifikuara.

Neni 6

Analizimi i Rendit Publik dhe Situatave Kriminale

Agjencitë bashkëpunuese do të shkëmbejnë në mënyre të rregullt informacionet dhe analizat sa i përket situatës së krimit dhe situatës së rendit publik të shteteve të tyre. Agjencitë bashkëpunuese mundën bashkërisht të analizojnë çështjet e situatën e krimit dhe parandalimin e krimit dhe të diskutojnë dhe pajtohen për veprimet të cilat duhet të merren.

Neni 7

Marrja e veprimeve në raste urgjente

- (1) Me qëllim të sigurimit të gjurmëve dhe dëshmive, agjencitë bashkëpunuese, brenda territorit të shteteve të tyre, sipas kërkesës, në përputhje me ligjet kombëtare të shteteve të tyre, mund të bëjnë kontrolle të identitetit, kontrolle intensive në vende publike, mund të kapin dhe ndalojnë një person të kërkuar, të kontrollojnë ndërtesa, godina, vendin e krimit, rroba, pako dhe automjete, nëse interesi i luftimit të krimit kërkon masa urgjente.
- (2) Agjencia kërkuese bashkëpunuese do të njoftohet menjëherë për masat e specifikuar në Paragrafin (1).

Neni 8

Dërgesa e kontrolluar

- (1) Agjencitë bashkëpunuese të Palëve Kontraktuese përmes agjencive qendrore të kontaktit mund të kërkojnë nga agjencitë bashkëpunuese të Palës tjetër Kontraktuese të mbikëqyrin dërgesat e ligjshme dhe të dyshuara për të kaluar, përmes apo në territorin e shtetit të saj, në mënyrë që të zbulojë krimin, dhe identifikojë personat të cilat kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës kriminale.
- (2) Përveç të dhënave të përcaktuara në Nenin 4 Paragrafi (1) i kësaj Marrëveshje, kërkesa për dërgesa të kontrolluara do të përfshijë:

- a) Përmbajtja e dërgesës, rruga dhe kohëzgjatja e pritshme e saj, mënyra e transportimit dhe të dhënat në lidhje me identifikimin e mjeteve të transportimit;
- b) Mënyra e eskortës;
- c) Të dhëna në lidhje me instrumentet teknike të cilat do të përdoren;
- d) Numri i pjesëmarrësve dhe pjesëmarrja e zyrtarëve të mbuluar, nëse ka ndonjë, në eskortë në pjesën e kërkesës së agjencisë bashkëpunuese;
- e) Mënyra e mbajtjes së kontaktit me pjesëmarrësit në dërgesën e kontrolluar;
- f) Rrethanat e dorëzimit dhe pranimit të dërgesës;
- g) Masat të cilat do të merren në rast të kapjes;
- h) Masat të cilat do të merren në rast të ngjarjeve të papritura.

(3) Agjencitë qendrore të kontaktit – në rast të pranimit të kërkesës – do të pajtohen për datën dhe *modus operandi* të dërgesës së kontrolluar dhe shtrirjen e përfshirjes së tyre në raste të tilla. Agjencia e kërkuar qendrore e kontaktit mund të kufizojë apo të refuzojë dërgesën e kontrolluar nëse ajo rrezikon personat të cilët marrin pjesë në të apo rendin publik deri në një shkallë të papranueshme.

(4) Agjencia e kërkuar bashkëpunuese do të jetë në krye të dërgesës së kontrolluar; agjencia kërkuese bashkëpunuese do të jetë e informuar për personin në krye. Dërgesa e kontrolluar do të ekzekutohet ashtu që të jetë e mundshme të pengohet në çdo kohë. Pas marrjes, agjencia kërkuese bashkëpunuese mund të shoqërojë dërgesën mirëpo nuk mund të ushtrojë autorizime zyrtare. Në rrjedhën e kësaj, anëtarët e agjencisë kërkuese bashkëpunuese do të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij Neni, ligjet e shtetit të agjencisë së kërkuar bashkëpunuese dhe instruksionet e personit në krye të agjencisë kërkuese bashkëpunuese.

(5) Sipas ekzistencës së kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, agjencitë qendrore të kontaktit gjithashtu do të lejojnë ekzekutimin e dërgesave të kontrolluara duke filluar nga një shtet i tretë dhe arritjes në shtetin tjetër. Në këtë rast, agjencia kërkuese qendrore e kontaktit do të marrë paraprakisht pëlqimin e shtetit në fjalë, nga i cili agjencia e kërkuar qendrore e kontaktit do të njoftohet.

(6) Pjesëmarrja e zyrtarëve të fshehtë në shoqërimin e dërgesave të kontrolluara do të i nënshtrohet lejes së autoriteteve gjyqësore të Palës Kontraktuese që i zhvillon ato.

Neni 9

Dislokimi i Zyrtarëve të mbuluar

(1) Agjencitë bashkëpunuese sipas kërkesës mund të pajtohen për dërgimin e agjentëve të mbuluar të agjencisë kërkuese bashkëpunuese brenda territorit të shteteve të tyre nëse kjo është e nevojshme për zbulimin e suksesshëm të akteve kriminale, të kryera apo të tentuar në territorin e shtetit të tyre. Zyrtari i fshehtë është anëtarë i personelit të rregullt të një agjencie bashkëpunuese, i

autorizuar në bazë të ligjeve të brendshme të Palëve Kontraktuese për veprim të fshehtë për të mbledhur inteligjencën kriminale.

(2) Leja e autoriteteve gjyqësore lidhur me një zyrtar të fshehtë të referuar në Paragrafin (3) të Nenit 3 të kësaj Marrëveshje do të aplikohet në tërë territorin e Palëve Kontraktuese.

(3) Kërkesa për dërgimin e një zyrtari të mbuluar përveç të dhënave të përcaktuara në Paragrafin (1) të nenit 4 të kësaj Marrëveshje, do të përfshijë:

- a) kohëzgjatjen e dërgimit të zyrtarit të mbuluar;
- b) Kushtet e dërgimit të zyrtarit të mbuluar;
- c) Të drejtat dhe detyrimet e zyrtarit të mbuluar;
- d) Masat për tu ndërmarrë në rastin kur identiteti i zyrtarit të mbuluar është zbuluar;
- e) Informacione sa i përket dispozitave relevante që specifikon detyrimin civil të zyrtarit të mbuluar;
- f) Informacione në lidhje me dispozitat relevante të rregulloreve ligjore të cilat specifikojnë detyrimin civil të zyrtarit të mbuluar për dëmet e shkaktuara brenda fushëveprimit të tij / saj.

(4) Dislokimi i një zyrtari të mbuluar do të kufizohet në raste individuale dhe do të zgjasë për një periudhë të veçantë kohore. Zyrtari i mbuluar mund të fillojë aktivitetin e tij / saj pas një marrëveshje *ad hoc* në mes të agjencive bashkëpunuese dhe pasi të kenë marr lejen në përputhje me Parafin (2) të saj. Aranzhimet do të përmbajnë çështjet e përcaktuara në Paragrafët (3) dhe (6).

(5) Aktivitetet e zyrtarit të mbuluar duhet menjëherë të suspendohen nëse kështu kërkon agjencia e kërkuar bashkëpunuese.

(6) Veprimet e zyrtarit të mbuluar do të qeverisën nga ligjet e brendshme të agjencisë së kërkuar bashkëpunuese. Zyrtari i fshehtë mund të ndërmerr vetëm veprime të lejuara nga ligjet e brendshme të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 10

Bashkëpunimi në programin e mbrojtjes së dëshmitarit

(1) Palët Kontraktuese mund të kërkojnë përmes autoriteteve të tyre kompetente që dëshmitarët, viktimat dhe personat e lidhur me ta nën mbrojtje (tutje: personat e mbrojtur) të transferohen nga territori i shtetit të një Pale Kontraktuese tek territori i shtetit të Palës tjetër Kontraktuese dhe që atyre tu jepet mbrojtja, duke përfshirë mbështetje teknike dhe logjistike. Bashkëpunimi nuk do të shtrihet tek personat e mbrojtur të arrestuar. Këto masa nuk duhet të pengojnë procedimet penale në territoret e shteteve të Palëve Kontraktuese.

(2) Personi i cili do të mbrohet duhet të jetë vendosur nën Programin kombëtar të Mbrojtjes së Dëshmitarit të Palës kërkuese Kontraktuese para transferimit. Në rast të nevojës urgjente transferimi mund të zbatohet nëse supozhet se personi i cili do të mbrohet është marr në Programin kombëtar të Mbrojtjes së Dëshmitarit të Palës kërkuese Kontraktuese (masë emergjente). Personat e mbrojtur

mund të përfitojnë vetëm nga format e mbrojtjes të cilat janë paraparë nga ligjet kombëtare për mbrojtjen e dëshmitarit të shtetit të agjencisë së kërkuar.

(3) Përveç të dhënave të specifikuara në Nenin 4 Paragrafi 1 i kësaj Marrëveshje, kërkesa e referuar nën Paragrafin (1) duhet të përmbajë:

- a) kërkesën për konfidencialitet;
- b) statusi i personit të mbrojtur në procedura penale;
- c) informacione në lidhje me kërcënimin e personit dhe ashpërsia e tij;
- d) arsyet për lëvizjet e personit të mbrojtur në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese;
- e) forma e rekomanduar dhe niveli i mbrojtjes;
- f) kohëzgjatja e nevojshme e qëndrimit në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese dhe mundësia e shtyrjes.

(4) Pasi kërkesa është aprovuar, autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese, në të shkruar, do të pajtohen për detajet e mbrojtjes dhe mënyrat e mbajtjes së kontaktit.

(5) Nëse mbrojtja nuk mund të garantohet më, agjencia kërkuuese kompetente do të informojë menjëherë për këtë.

(6) Personi i mbrojtur do të respektojë ligjet e shtetit të agjencisë së kërkuar. Nëse personi i mbrojtur shkel ligjet e brendshme të shtetit të agjencisë së kërkuar bashkëpunuese apo dështon të respektojë rregullat e sjelljes të përcaktuara për të, agjencia kërkuuese kompetente menjëherë do të njoftojë për këtë. Nëse agjencia e kërkuar konsideron si të nevojshme të fillojë kthimin e personit të mbrojtur në fjalë, agjencia kërkuuese do të respektojë këtë iniciativë.

(7) Në mënyrë që të sigurohet konfidencialiteti i masave mbrojtëse, zyrtarët e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese mund të fshehin identitetin e tyre origjinal dhe automjetet e përdorura.

Neni 11

Vendosja e Ekipeve të Përbashkëta të Zbulimit të Krimit

(1) Agjencitë bashkëpunuese, munden, nga një marrëveshje *ad hoc*, të vendosin ekipe të përbashkëta të zbulimit të krimit nëse kjo është e nevojshme për zbulimin e suksesshëm të akteve kriminale, të kryera apo të tentuar në territorin e shteteve të tyre.

(2) Aranzhimi sipas paragrafit (1) në mënyrë te veçant do të përfshijë:

- a) Përshkrimin e veprës kriminale për të cilën është vendosur ekipi i përbashkët i zbulimit të krimit;
- b) Fusha, kushtet dhe kohëzgjatja e veprimit dhe kushtet e zgjatjes;
- c) Përbërja dhe drejtuesi i ekipit të përbashkët të zbulimit të krimit;
- d) Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit dytësor (të transferuar) të ekipit të përbashkët për zbulimin e krimit;

e) Informacione në lidhje me rregullat që qeverisin detyrimet penale të anëtarit dytësor (të transferuar) të ekipit të përbashkët për zbulimin e krimit si dhe detyrimet e tij apo të saj civile për dëmet e shkaktuara brenda fushëveprimit të tij / saj;

f) Masat organizative dhe mbulimi i shpenzimeve të veprimit.

(3) Anëtari i agjencisë kërkuese bashkëpunuese i ri caktuar për ekipin e përbashkët për zbulimin e krimit nuk do të autorizohet për të ndërmarrë veprime të pavarura në territorin e agjencisë bashkëpunuese kërkuese.

(4) Anëtari i agjencisë kërkuese bashkëpunuese dytësor (transferuar) i caktuar për ekipin e përbashkët të zbulimit të krimit mund të transferojë të dhëna të jo klasifikuara dhe informacione në posedim të tij / saj tek anëtarët e agjencisë bashkëpunuese kërkuese pjesëmarrëse në ekipin e përbashkët të zbulimit të krimit në të njëjtat raste sikurse në rastin e transferimit të informacioneve të tilla tek agjencia e tij / saj bashkëpunuese.

(5) Qasja në të dhënat e klasifikuara, të klasifikuara nga agjencitë bashkëpunuese të nevojshme për punën e ekipit të përbashkët të zbulimit të krimit do të i jepet zyrtarëve dytësor (transferuar) caktuar të agjencive bashkëpunuese të Palës tjetër Kontraktuese nga kreu i autoritetit pasi të kenë vendosur ekipin e përbashkët për zbulimin e krimit sipas ligjeve të shteteve të tyre. Për të transferuar të dhëna të klasifikuara nga autoritetet jo pjesëmarrëse në bashkëpunim, duhet të merret pëlqimi i klasifikuesit.

Neni 12

Mbledhja e fshehtë e informacioneve

(1) Agjencitë bashkëpunuese të Palëve Kontraktuese, në rrjedhën e zbulimit të krimit, sipas kërkesës dhe në përputhje me ligjet e brendshme të shteteve të tyre, mund të mbledhin informacione në mënyrë të fshehtë dhe të informojnë njëra tjetrën për rezultatet.

(2) Përveç të dhënave të përcaktuara në Nenin 4 Paragrafi (1) i kësaj Marrëveshje, kërkesa për mbledhje të fshehtë të informacioneve duhet të përfshijë:

- a) caklimin e mjetit po metodës;
- b) kohëzgjatjen e masës së fshehtë;
- c) fushëveprimin e të dhënave të cilat do të regjistrohen dhe transferohen;
- d) mënyrën e transferimit të të dhënave;
- e) mënyrën e sigurimit të asistencës në rast të mbulimit të fshehtë të informacioneve në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese;
- f) konfirmimi i faktit se mbledhja e fshehtë e informacioneve në shtetin e agjencisë kërkuese bashkëpunuese është autorizuar në mënyrë të duhur.

(3) Agjencia e kërkuar bashkëpunuese do të fillojë përpunimin e kërkesës në përputhje me ligjet e brendshme të shtetit të tij, kur është e nevojshme, pas marrjes së autorizimit.

Neni 13
Ri Caktimi i Zyrtarëve Ndërlidhës

(1) Secila agjenci bashkëpunuese, me autorizim të agjencisë kompetente bashkëpunuese e Palës tjetër Kontraktuese, mund të caktojë zyrtarët ndërlidhës tek agjencitë bashkëpunuese të Palës tjetër Kontraktuese për një periudhë të specifikuar. Atasheu i brendshëm / i zbatimit të ligjit i akredituar për trupa diplomatike të Palës pranuese Kontraktuese mund gjithashtu të kryejë detyra të zyrtarëve ndërlidhës.

(2) Qëllimi i caktimit të zyrtarëve ndërlidhës është që të zgjerohet bashkëpunimi në mes të Palëve Kontraktuese dhe për të siguruar asistencë të vazhdueshme në:

- a) Shkëmbimin e informacionit të dëshiruar për parandalimin dhe luftimin e akteve kriminale;
- b) Ekzekutimin e kërkesave të lidhura me zbatimin e kësaj Marrëveshje;
- c) Bashkëpunimi lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të ri pranimit;
- d) Transferimit të informacioneve të kërkuara për kryerjen e detyrave të autoriteteve të ngarkuara me parandalimin e kërcënimeve të cilat rrezikojnë rendin publik.

(3) Zyrtari ndërlidhës do të ketë një rol konsultativ duke mbështetur agjencitë bashkëpunuese dhe nuk do të autorizohet për të kryer masa të parandalimit të krimit dhe luftimit së krimit në mënyrë të pavarur.

(4) Ministrinë kompetente të Palëve Kontraktuese do të pajtohen për kushtet e detajuara të veprimit të zyrtarit ndërlidhës.

(5) Ministrinë kompetente të Palëve Kontraktuese mund të pajtohen që zyrtari ndërlidhës i Palës Kontraktuese i cili vepron në një shtet të tretë përfaqëson interesin e Palës tjetër Kontraktuese në këtë vend të tretë.

Neni 14
Bashkëpunimi në fushën e Trajnimit dhe Parandalimit të Krimit

(1) Bashkëpunimi në fushën e trajnimit do të ketë shtrirje si në vijim:

- a) Shkëmbimi i plan programeve dhe materialeve mësimore;
- b) Seminare dhe prezantime të përbashkëta, organizimi i kurseve dhe konferencave të përbashkëta;
- c) Ftesat e përfaqësuesve të agjencive të tjera bashkëpunuese si vëzhgues, prezantimi i ushtrimeve dhe veprimet e veçanta të dislokimit;
- d) Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të agjencive të tjera bashkëpunuese në kurse.

(2) Agjencitë qendrore të kontaktit do të bashkëpunojnë në eksplorimin dhe shkëmbimin e metodave në parandalimin e krimit të dëshmuara në nivel kombëtar dhe në organizimin e konsultimit të ekspertëve të nevojshëm për zbatimin e metodave të parandalimit të krimit.

Neni 15**Bashkëpunimi në luftimin e korrupsionit dhe shpërdorim të detyrës zyrtare**

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese bazuar në këtë Marrëveshje do të bashkëpunojnë në luftimin e korrupsionit dhe shpërdorimin e detyrës zyrtare. Bashkëpunimi mbulon shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me aplikimin e ligjeve dhe parandalimin e korrupsionit, dhe shkëmbimin e informacioneve dhe analizimi sa i përket arsyeve të mundshme të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës dhe trendët e zhvillimit.

KAPITULLI IV**Aspektet Ligjore në Territorin e Palës tjetër Kontraktuese****Neni 16****Të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve**

(1) Zyrtarët e agjencive bashkëpunuese kanë të drejtë të veshin uniformën e tyre dhe janë të detyruar të mbajnë kartën e tyre të identifikimit të shërbimit në rrjedhën e kryerjes së detyrave të tyre të cilat dalin nga kjo Marrëveshje në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese. Ata nuk kanë të drejtë të mbajnë armë të tyre të shërbimit dhe pajisje të shërbimit, dhe të përdorin mjetet e forces (shtrëngimit).

(2) Zyrtari i mbuluar, i referuar në Nenin 9 të kësaj Marrëveshje, mund të hyjë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese me një dokument të fshehtë, mund të qëndrojë aty me dokumentet e nevojshme të fshehta për periudhën e kryerjes së detyrave të tij / saj. Zyrtarët e mbuluar mund të mbajnë armë zjarri dhe të përdorin mjete të kufizuara ashtu siç është rregulluar me marrëveshjet e definuar në Paragrafin (4) të Nenit 9 të kësaj Marrëveshje.

Neni 17**Çështjet e shërbimit dhe mbrojtja e anëtarëve të Agjencive Bashkëpunuese**

(1) Çështjet e shërbimit, detyrimet e punësimit dhe përgjegjësia disiplinore të anëtarëve të agjencisë bashkëpunuese kërkuese do të rregullohen nga ligjet e shtetit të tij / saj.

(2) Agjencia r bashkëpunuese kërkuese do të ofrojë mbrojtjen dhe ndihmën e njëjtë ndaj anëtarëve të agjencisë bashkëpunuese të Palës tjetër Kontraktuese të cilët kryejnë detyrat e tij / saj sipas kësaj Marrëveshje në territorin e tyre sikurse një anëtar i agjencisë së vet bashkëpunuese.

Neni 18**Rregullat për përgjegjësinë penale**

Anëtarët e agjencive bashkëpunuese të cilët kryejnë detyrat e tyre sipas kësaj Marrëveshje në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese do të trajtohen në të njëjtën mënyrë në kuptim të shkeljeve penale të kryera nga ata apo kundër tyre, sikurse zyrtarët e agjencisë bashkëpunuese në territorin e së cilës ata ushtrojnë aktivitetet e tyre.

Neni 19
Rregullat e përgjegjesisë Civile

- (1) Kur një anëtar i agjencisë bashkëpunuese kryen detyrat e tij / saj në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, Palë Kontraktuese e cila e dërgon atë do të jetë përgjegjëse për çdo dëm të shkaktuar nga ai / ajo në rrjedhën e veprimeve të tij / saj në përputhje me ligjet e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës dëmi është shkaktuar.
- (2) Pala Kontraktuese, në territorin e së cilës dëmi i referuar në Paragrafin (1) ka ndodhur, do të paguajë kompensim për dëmin sipas kushteve të njëjta ashtu sikurse dëmi është shkaktuar nga vetë zyrtarët e tij.
- (3) Pala Kontraktuese, anëtar i agjencisë bashkëpunuese i së cilës ka shkaktuar dëme ndaj personit të tretë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, do të rimbursojë shumën e plotë të dëmeve të paguara nga Pala e fundit Kontraktuese ndaj personit të lënduar apo personit tjetër me të drejtë të përfaqësimit në emër të personit të lënduar.
- (4) Pa paragjykim për ushtrimin e të drejtave të tyre të dalura vis a vis personit të tretë dhe me përjashtim të dispozitave të Paragrafit (3), Pala Kontraktuese në mënyrë të ndërsjellë heq dorë nga ndonjë pretendim për rimbursim të dëmeve të qëndrueshme nga Pala tjetër Kontraktuese përveç nëse është shkaktuar dëm me qëllim apo nga neglizhenca e madhe në rastet sipas paragrafit (1).

KAPITULLI V
Mbrojtja e të Dhënave

Neni 20
Rregullat e përpunimit të të dhënave

- (1) Përpunimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me dispozitat si në vijim:
- a) Kërkesa do të tregojë llojin e të dhënave të kërkuara, qëllimin dhe bazën ligjore të përdorimit të tyre;
- b) Agjencia bashkëpunuese e pranimit të të dhënave (tutje pranuesi) mund të përdorin të dhënat ekskluzivisht për qëllimet e specifikuar në këtë Marrëveshje dhe sipas kushteve të përcaktuara nga agjencia bashkëpunuese e transferimit të të dhënave (tutje dërguesi). Pranuesi do të ofrojë informacione për dërguesin sipas kërkesës për përdorimin e të dhënave të transferuara nga dërguesi;
- c) Para transferimit të të dhënave, pasi është konstatuar se transferimi i të dhënave ka qenë i nevojshëm për qëllimin e treguar, dhe ishte proporcional me të dhe ishte në linjë me ligjet e brendshme të shtetit të tij, do të sigurohet se të dhënat të cilat do të transferohen janë korrekte;
- d) Pas transferimit të të dhënave, dërguesi, në përputhje me ligjet e brendshme të shtetit të tij, do të tregojë afatet kohore për mbajtjen e të dhënave, sipas skadimit të të cilave pranuesi duhet të fshijë apo të bllokojë të dhënat apo të shikoj nëse ato janë ende të nevojshme apo jo. Pavarësisht këtyre afateve kohore të dhënat e transferuara do të fshihen sapo ato të mos jenë të kërkuara për qëllimin për të cilin janë transferuar.

e) Të dhënat mund të transferohet vetëm tek agjencia e autorizuar bashkëpunuese referuar në Nenin 1 të kësaj Marrëveshje. Të dhanë mund të përcillen tek agjencitë e tjera me pëlqimin paraprak në të shkruar të dërguesit bazuar në shqyrtimin e kushteve të përcaktuara në Pikën c);

f) Agjencitë të cilat përpunojnë të dhënat do të mbajnë shënime të të dhënave të transferuara dhe të pranuar bazuar në këtë Marrëveshje të cilat së paku do të përmbajnë: qëllimin dhe përmbajtjen e të dhënave të ofruara, bazën ligjore të transferimit, llojin e të dhënave të transferuara, agjencinë transmetuese dhe pranuese dhe kohën dhe datën e transferimit, dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e subjektit të të dhënave. Ofrimi online i të dhënave do të regjistrohet menjëherë. Regjistrimet do të mbahen për një periudhë të specifikuar në ligjet e brendshme të aplikueshme për të dhëna të tilla, mirëpo së paku për pesë vite. Regjistrimet mund të përdoren vetëm për të mbikëqyrur përputhshmërinë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave.

(2) Palët Kontraktuese janë të detyruara që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme organizative dhe teknike në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje efektive të të dhënave, dhe kundër qasjes, dislokimit, alterimit dhe shkatërrimit të paautorizuar pa pëlqimin paraprak.

(3) Autoritet e pavarura mbikëqyrëse të mbrojtjes së të dhënave të Palëve Kontraktuese të cilat do të jenë të përgjegjshme për sigurimin e respektimit të parimeve dhe rregullave të përmbajtura në këtë Marrëveshje kanë të drejtë të kontrollojnë përputhshmërinë me rregullat e përpunimit të rregullave sipas kësaj Marrëveshje.

(4) Kjo Marrëveshje nuk do të sigurojë bazat për kërkesat për të transferuar të dhëna apo informacione të cilat do të përdoren si dëshmi në procedime penale. Të dhënat apo informacionet e transferuara në linjë me këtë Marrëveshje nuk duhet të përdoren për asistencë të ndërsjellë në çështje penale pa pëlqimin paraprak të Palës transferuese Kontraktuese, e cila duhet të jepet në përputhje me ligjet e brendshme dhe në përputhje me marrëveshjet bilaterale apo multilaterale të aplikueshme në asistencën e ndërsjellë në çështje penale.

Neni 21

Informacione për Subjektin e të dhënave

(1) Palët Kontraktuese do të sigurojnë që subjekti i të dhënave është i informuar në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të tij / saj nga autoritetet e tyre kompetente. Derogimi nga ky Nen do të lejohet kur një derogim i tillë përbën një masë të nevojshme në interes të mbrojtjes së sigurisë së shtetit, sigurisë publike apo luftimit të veprave penale, subjektin e të dhënave apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

(2) Kur të dhënat personale të jenë transferuar, secila agjenci bashkëpunuese, në përputhje me dispozitat e ligjeve të brendshme të shtetit të tij, mund të kërkojë që agjencia bashkëpunuese e Palës tjetër Kontraktuese të mos informojë subjektin e të dhënave. Në rast të tillë agjencia e fundit bashkëpunuese nuk do të informojë subjektin e të dhënave pa pëlqimin paraprak të agjencisë bashkëpunuese të Palës tjetër Bashkëpunuese. Në raste të tjera Pala pranuese do të konsultojë Palën dërguese se a mund të informojë subjektin e të dhënave për të dhënat e tij / saj personale dhe të ndjeshme të mbajtura në regjistra dhe në lidhje me qëllimin e përdorimit të tyre. Pala pranuese do të veprojë në përputhje me instruksionet e dhëna nga Pala dërguese.

(3) Subjekti i të dhënave do të mundësojë të marrë, ashtu siç mund të jetë rasti, të sigurojë apo blloktojë të dhënat e tij / saj personale dhe sensitive nëse këto janë proceduar në kundërshtim me

dispozitat e kësaj Marrëveshje, dhe të kenë kompensim nëse një kërkesë për konfirmim apo, ashtu siç mund të jetë rasti, komunikimi, korrigjimi, fshirja apo bllokimi nuk është respektuar.

Neni 22

Mbrojta e të dhënave të klasifikuara

Për të mbrojtur të dhënat e klasifikuara dhe informacionet e pranura në rrjedhën e zbatimit të kësaj Marrëveshje, agjencitë bashkëpunuese do të aplikojnë dispozitat vijuese:

a) Të dhënat e klasifikuara sipas ligjeve të shtetit të Palës dërguese që transferon të dhënat e klasifikuara do të i jepet niveli i njëjtë i mbrojtjes nga Pala pranuese e cila pranon të dhënat e klasifikuara sikurse pajtimi për mbrojtjen për të dhënat e furnizuara me shenjën klasifikuese në përputhje me ligjet e brendshme të tij bazuar në tabelën e ekuivalencës e cila përbën shtojcën e kësaj Marrëveshje. Kjo shtojcë do të përbëjë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshje;

b) Pala dërguese e cila transferon të dhënat do të tregojë periudhën e vlefshmërisë së të dhënave të klasifikuara të transferuara;

c) Pala Dërguese e cila transferon të dhënat do të njoftojë menjëherë në të shkruar Palën pranuese e cila pranon të dhënat e klasifikuara, për çdo ndryshim lidhur me të dhënat dhe ndonjë modifikim në shënjinimin e tyre klasifikues apo periudhën e vlefshmërisë apo përfundimin e klasifikimit. Pala pranuese e cila pranon të dhënat do të modifikojë shënjinimet e klasifikuara apo periudhën e vlefshmërisë apo do të përfundojë përpunimin ashtu sikurse të dhënat e klasifikuara janë në përputhje me këtë njoftim;

d) Përcjellja e çdo të dhëne të klasifikuar të transferuar sipas kësaj Marrëveshje do të lejohet me pëlqimin në të shkruar të autoriteteve apo personit i cili ka kompetencë sipas ligjeve të brendshme të shtetit të dërguesit;

e) Pala dërguese e cila transferon të dhënat e klasifikuara do të njoftohet menjëherë në lidhje me ndonjë shkelje të ligjeve të cilat shërbejnë për mbrojtjen e të dhënave të klasifikuara të transferuara e kryer nga Pala pranuese e cila pranon të dhënat e klasifikuara. Njoftimi do të ketë shtirje tek rrethanat dhe pasojat e shkeljes së ligjeve, masat e ndërmarra për të përmbajtur pasojat të tilla dhe masat e ndërmarra për të parandaluar ndonjë shkelje të ardhshme të këtyre dispozitave.

KAPITULLI VI Dispozitat mbyllëse

Neni 23


Rregullat e mbulimit të shpenzimeve

Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje apo me pajtimin e agjencive qendrore të kontaktit, të dyja Palët Kontraktuese do të mbulojnë shpenzimet e shkaktuara në rrjedhën e veprimeve të agjencive të tyre bashkëpunuese.

të Bashkuara. Pala Kontraktuese Hungareze do të njoftoj Palën Kontraktuese Kosovare pa asnjë vonesë në lidhje me regjistrimin.


E përfunduar në Prishtinë në këtë ditë të 31.07.2013 në dy kopje origjinale në gjuhën, Shqipe, Serbe, Hungareze dhe Angleze të gjitha tekstet të jenë njëllorj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin e kësaj Marrëveshje, teksti në gjuhën Angleze do të mbizotëroj.

Në emër të Republikës së Kosovës



A circular official stamp of the Republic of Kosovo is partially visible behind the signature. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES" and "PRISTINE".

Në emër të Hungarisë



31.07.2013

Shtojcë

e Nenit 22 e Marrëveshjes
në mes të Republikës së Kosovës dhe Kosovës për Bashkëpunim në Parandalimin dhe
Luftimin e Krimit

Shënimi i të dhënave të klasifikuara dhe ekuivalenca e tyre

Palët Kontraktuese – në pikëpamje të dispozitave të Nenit 22 (a) të Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për bashkëpunim në Parandalimin dhe Luftimin e Krimit – vërtetojnë se në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës dhe ato të Hungarisë se shënimet e poshtme klasifikuese të të dhënave të klasifikuara janë ekuivalente.

Në Republikën e Kosovës	Në Hungari	Ekuivalente në Anglisht
Tepër sekret	„Szigorúan Titkos!”	TOP SECRET
Sekret	„Titkos!”	SECRET
Konfidenciale	„Bizalmas!”	CONFIDENTIAL
E Kufizuar	„Korlátozott terjesztésű!”	RESTRICTED